



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 24.09.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.09.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "El-Bau Shpk" për aktivitetin: "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik**" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-025-211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "El Bau Shpk" e datës 24.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik**" me Nr. 616 18 440 211 Nr. Brendshëm : 616 -18-025-211 kundër *njoftimit të kontratës* të AK –së, të datës 23.08.2018 dhe korigjimit të njoftimit të datës 10.09.2018 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. *Aprovohet njoftimi dhe ndryshimi i njoftimit për kontratë* i publikuar me datë: 23.08.2018 dhe 10.09.2018 ;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të dates 23.08.2018 dhe 10.09.2018 .*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "El Bau Shpk" me datë 24.09.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ' "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik**"' me numër të prokurimit Nr. 616 18 440 211 dhe numër të brendshëm 616 18 025 211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 24.09.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Lidhur me pretendimin se Autoriteti Kontraktues ka paraqitur kërkesa selektive per te deshmuar paisjet eshte i paqendrueshem per faktin se te gjitha mjetet ose duhet te kene libreze te qarkullimit ose deklarate unike doganore , i cili dokument leshohet per cdo mjet qe kalon nepermes doganes pa marre parasysh se a duhet te regjistrohet apo jo .

Lidhur me pretendimin tjeter se nuk ka nevoje per licence per menaxhim te mbeturinave duke e trajtuar si kerkese sekondare , poashtu eshte i paqendrueshem pasi qe asnje kompani e palicensuar nuk mund te nenshkruaj kontrate me deponine per menaxhim te mbeturinave , qe do te thote se nuk mund te dorezoj mbeturinat e grumbulluara ne qytet .Pa marre parasysh sezonen e mirembajtjes grumbullimi dhe dorezimi i mbeturinave eshte veprim i perditshem dhe te njejtat duhet te dorezohen ne deponi . Per kete arsye ne te gjitha publikimet paraprake lidhur me mirembajtjen pamarre parasysh sezonen eshte kerkuar cdo here edhe licenca per menaxhim te mbeturinave .

Departamenti i Prokurimit nuk e ka paraqitur kerkesen ne baze te pyetjes se OE-ik , por ne baze te sqarimit qe eshte kerkuar nga njesia e kerkeses DSHP, permbajtja e te cilit eshte paraqitur me larte .

Bazuar ne sqarimet paraprake rrjedh se Autoriteti Kontraktues nuk ka vendosur asnje kriter diskriminues por kriteret qe jane ne harmoni me kerkesat e sherbimit te kerkuar ne dosjen e tenderit .

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit